

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 5076/11 Prot.

Tiranë, 10/2/2017

Drejtuar: Z. Besnik Dervishi
Komisioner
Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. Prot. 199/1, datë 06/02/2017, (Protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me Nr. Prot. 5076 datë 07.02.2017), Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ju bën me dije se:

Gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor sipas fazave të përcaktuara në ligj dhe në termat e referencës të përcaktuara nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe AKPT, dhe sipas objektivave të përcaktuara në dokumentin e Nismës të PPV-së, miratuar nga Këshilli Bashkiak në datë 23/12/2015 me vendimin nr 22274, Bashkia e Tiranës ka organizuar konsultime publike në çdo njësi administrative si dhe dëgjesa publike në datat: 08/04/2016, 21/06/2016, 10/10/2016.

Gjithashtu, në datën 26/12/2016 Këshilli Bashkiak ka organizuar dëgjese publike shtesë për anëtarët e Këshillit Bashkiak si dhe grupet e interesit.

Të gjitha procesverbalet dhe publikimet janë realizuar në konformitet të plotë me përcaktimet ligjore të ligjit 107/2014, dt. 01/10/2014, në Regjistrin e Integruar të Territorit, të cilat gjithashtu po i përcjellim bashkëlidhur kësaj shkrese.

Me respekt,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



RAPORT
TIRANA CALLING BUJQËSI/ USHQIM
TRYEZË E RRUMBULLAKËT I

PJESËMARRËSIT

1. Hana Narvaez (SBA) koordinator
 2. Felix Madrazo (IND) koordinator
 3. Ani Marku (asistent koordinator)
 4. Artur Galanxhi
 5. Arjeta Rudha
 6. Ledina Gjondedaj
-

PËRMBLEDHJE

Zona përreth Tiranës ka një potencial të madh për zhvillimin e bujqësisë.

Lugina e lumit Erzen është një zonë që ka qenë e frytshme në të kaluarën në këtë aspekt dhe mbetet ende e tillë.

Në korridorin Pezë-Ndroq-Vaqarr kultivohen masivisht ullinj dhe pemë frutore.

Zona e Bërzhitës është e njohur për kultivimin e perimeve.

Zonat Baldushk, Petrelë, Farkë janë të njohura për kultivimin e ulljve dhe vreshtave.

Mund të bëhet Tirana një metropol i madh bujqësor?

Tirana është e rrethuar nga toka pjellore, kështu që ka të gjitha mundësitë për tu bërë një metropol i madh bujqësor, por fillimisht duhen trajtuar disa çështje si:

- Mungesa e Organizatave
- Informaliteti
- Pronësia e tokës
- Siguria e kualitetit të produkteve ushqimore

- Organizimi i sistemit të tregjeve
- Krijimi i mundësive të reja
- Fonde
- Strategji për zhvillimin e zonës
- Rrugë
- Sistemi i ujitjës (85% e rezervuarëve përreth Tiranës nuk funksionojnë)




Figura 1 Sketch by Ani Marku

Ku duhet të konsistojë organizimi:

- në prodhim
- në shpërndarje

Bizneset private gjithashtu mund të ndihmojnë në zhvillimin bujqësor me investime financiare.

RAPORT

TIRANA CALLING Ekonomi / Industri Përpunuese

TAVOLINA E RRUMBULLAKËT 3

PJESËMARRËSIT

1. Stefano Boeri (koordinator)
2. Arbi Mazniku (koordinator)
3. Joni Baboçi
4. Enkelejd Musabelliu
5. Jona Osmani
6. Erinda Pernaska
7. Jona Gramatiku

Përmbledhje

Temat kryesore të diskutuara në tryezën e rrumbullakët

1. Shërbime & Prodhime

- ii) Bujqësia
- iii) Agro-Turizmi
- iv) Zhvillimi si një majmun
- v) Industria e Lehtë: Fasone + Industria Tekstile
- vi) Auditimi
- vii) Transporti dhe Lëvizshmëria
- viii) Prodhimi i energjisë

2. Edukimi & Njohuritë

- i) Universitete + Biznese = Burime
- ii) Aktivitetet kulturore

3. Inovacioni & Teknologjia

- i) Call centers
- ii) SHërbime TIK
- iii) Linjat e Celularëve

4. Programe për të tërhequr Investime

- i) Zona të lira ekonomike
- ii) Bashkia e Tiranës + Investitorë (Bashkëinvestitorë)

Z. Musabelliu hap diskutimin duke përshkruar 4 themelet e strategjisë potenciale të zhvillimit:

Shtylla e parë : Të përqëndrohemi në shërbime në vend të prodhimit, kështu që Tirana duhet të përqëndrohet më tepër në cilësi se në sasi.

Shtylla e dytë : Të përqëndrohemi në edukim dhe njohuri. Zakonisht qytetet e vogla dhe të mesme i përqëndrojnë ekonomitë e tyre në universitete, për shembull Cambridge apo Oxford janë shembuj të qyteteve ku burimi kryesor i ekonomisë është universiteti.

Shtylla e tretë : Të përqëndrohemi në inovacion dhe teknologji.

Shtylla e fundit e strategjisë potenciale të zhvillimit për të ardhmen ishte tërheqja e MTI.

Cfarë mund të bëhet për të përqëndruar shoqërinë tonë drejt prodhimit dhe që cilësia të mbizotërojë mbi sasinë? Si mund të shndërrojmë vlerat e ulëta në fuqi punëtore të fuqishme?

Ne duhet ta përqëndrojmë ekonominë tonë drejt studentëve. Aryseja ka të bëjë me faktin që në Tiranë ka 48 universitete dhe pothuajse 65% të të gjithë studentëve shqiptarë janë në Tiranë. Ne duhet të konvertojmë burimin e njohurive në forcë punëtore të kualifikuar! Nxënësit duhet të trajnohen për t'u bërë sipërmarrës të ardhshëm dhe për këtë është e nevojshme një strategji afatgjatë.

Për sa i përket inovacionit dhe teknologjive, tek kjo temë duhet të përqëndrojmë vëmendjen tonë pak më shumë duke qënë se ajo është e pazhvilluar por ka një potencial të madh. Sektorë të tjerë mund të përfitojnë prej saj, dhe në mënyrë që vlera që mbart kjo fushë të fuqizohet është i rëndësishëm angazhimi i brezit të ri në këtë drejtim; një shembull për këtë janë aplikimet që të rinjtë mund të prodhojnë thjesht me anë të një kompjuteri.

Këto lloje të teknologjive krijuese kanë nevojë për klasa krijuese dhe kanë potencial për të tërhequr industri dhe për të sjellë fitime të mëdha.

Ne duhet të krijojmë programe të veçanta për të tërhequr investimet dhe për të arritur nivele më të larta të zhvillimit. Pothuajse 76% e të gjithë investitorëve të huaj janë në Tiranë, por ne kemi nevojë për programe më të mira për të tërhequr akoma më shumë. Për një periudhë 20 vjeçare ne duhet të rrisim përfitimet nga investimet e huaja me 4-5%. Sa i përket Bujqësisë, ka disa probleme lidhur me të, për shkak se sasia e tokës së punueshme në Tiranë e Re është relativisht e ulët. Por, agro-turizmi ka një potencial të madh për t'u bërë një biznes fitimprurës për klasën e mesme dhe të lartë të popullsisë, por nuk mund të kthehet kurrësi në një shtyllë të rëndësishme të ekonomisë. Produktet e sotme bujqësore janë më së shumti ullshte, vreshta rrushi, prodhime perimesh, pylltari dhe gjithashtu bagëti si dhi dhe dele.

Z. Mazniku hapi diskutimin duke paraqitur konceptin e Hausmann (profesor në Harvard) për zhvillimin. Ai përmendi se zhvillimi është si një majmun i cili lëviz dhe hidhet nëpër pemë që janë pranë tij në mënyrë që të arrijë në pemë të tjera më të larta sipas parashikimit të tij; Z. Mazniku sugjeron që zhvillimi i Tiranës në vetvete duhet të jetë si ajo e një majmuni. Ne duhet të përcaktojmë atë që dimë të bëjmë, të përcaktojmë pemët që kemi pranë nesh dhe pastaj të vlerësojmë rrugët e mundshme të zhvillimit, sepse nuk ka rrugë tjetër më të sigurt për t'u zhvilluar plotësisht. Kjo ide tashmë është vërejtur në industrinë e lehtë të periudhës post-komuniste, dhe mund të përshpejtohet nëse ne mundësojmë procese të cilat mund të bëhen funksionale në të gjitha fazat përkatëse ndërmjetëse duke nisur nga konceptimi deri në shitje. Për më tepër, ne duhet të marrim përvojë nga vendet e tjera dhe të krijojmë hapësira për inkubatorët dhe programet start-up në lidhje me informacionin, arsimin dhe transmetimin. Universitetet, bizneset dhe shërbimet janë burimet të cilave u nevojitet një plan i tillë kaq i fuqishëm.

Turizmi është një tjetër shqetësim kryesisht në lidhje me cilësinë dhe kapacitetin, për shkak se është ende në nivele të ulëta. Për këtë arsye, janë të nevojshme strategji makro-ekonomike sepse duhet të dimë burimet dhe kompetencat në mënyrë që të llogarisim ndryshimet.

Por, përveç turizmit një problem tjetër është edhe mungesa e lehtësirave për inkurajimin e bizneseve të reja. Një ide e anëtarëve të Bashkisë ishte ajo e zonave të lira ekonomike, për të cilën janë duke u bërë negociatat me qeverinë në mënyrë që Bashkia të disponojë një ligj të atillë për të krijuar këto zona. Dy hapësira potenciale për krijimin e këtyre zonave janë: 1. përgjatë autostradës Tiranë-Durrës dhe 2. pranë Shtish-Tufinë.

Një çështje tjetër është mungesa e një linje alternative të transportit midis Tiranës dhe Durrësit. Një ide është për të vënë në funksion hekurudhën e vjetër dhe për të krijuar një kryqëzim të saj me Aeroportin e Rinasit (i cili nuk është pjesë e kufijve të rinj të Bashkisë Tiranë).

Përsa i përket aspektit kulturor, kjo është një çështje madhore për shkak të fondeve të kufizuara të Bashkisë : 150,000 € / vit. Ky buxhet relativisht i vogël bën të nevojshëm tërheqjen e sponsor-ve në mënyrë që të zhvillohet një numër më i madh aktivitetsh.

REPORT
TIRANA CALLING INFRASTRUKTURA
TAVOLINA 4

PJESMARRËS:

1. Francesca Cesa Bianchi	STEFANO BOERI ARCHITETTI
2. Maria Chiara Pastore	POLITEKNIKU I MILANOS
3. Namik Simixhiu	DREJTORIA E MBETJEVE URBANE
4. Henrik Hysenbegasi	DREJTORIA E INVESTIMEVE TE HUAJA
5. Dritan Bratko	INXHIJER HIDROTEKNIK
6. Arind Okaj	DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT
7. Ina Fali	SEKTORI I SHERBIMEVE POLITIKE
8. Erindi Bejko	DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE SHERBIMEVE PUBLIKE
9. Robert Mancellari	DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE SHERBIMEVE PUBLIKE
10. Niko Pano	INXHIJER HIDROENERGJITIK
11. Andi Papastefani	

Përmbledhje:

Ndotjet industriale dhe menaxhimi i dobët i burimeve konsiderohen si problematikë madhore në çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin. Politikat e dekadave të fundit të planifikimit qendror të kontrolluar dhe mungesa e theksuar e pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje kanë rezultuar në akumulimin e pa kontrolluar në vende të papershtatshme të mbetjeve të cilat kanë patur impakt negativ në mjedis. Në vitin 1993, Studimi i Strategjise Mjedisore e financuar nga Banka Kombetare, identifikoi problemet kryesore për çështjet mjedisore dhe rifreskoi strategjinë e mepcrparshme për zhvillimin dhe implementimin e Planit të Veprimit duke parashtruar problematikat e meposhtme :

- Erozioni i tokës në zonat kodrinore dhe ato fushore, gjithashtu prerja e pakontrolluar e pyjeve.
- Ndotja e sipërfaqeve ujore për shkak të mungesës së impjanteve të trajtimit të ujrave.
- Humbja e konsiderueshme e biodiversitetit e shkaktuara nga mungesa e theksuar e menaxhimit dhe administrimit të duhur të burimeve natyrore (parqet, pyjet, zonat e mbrojtura, bimeve ujore etj..)

Situata e furnizimit me ujë është shumë kritike për shkak të rrjetit tashmë të vjetër të ujësjellsit, humbjet dhe rrjedhjet e mëdha në pjesën më të madhe të rrjetit, ndërtimet informale, migrimi i brëndshëm i pakontrolluar i popullatës nga zonat rurale në ato urbane dhe mungesës së mirembajtjes dhe investimeve të reja. Përqindja e popullatës që furnizohet nga rrjeti i ujësjellsit është e paqarte, e cila varion nga 90 përqind në zonat e urbanizuara dhe 50 përqind në zonat rurale. Kjo paqartësi vjen si pasojë e mungesës së kriterëve në lidhje me rrjetin e ujësjellsit. Shumica e rrjetit të ujit të pishem është e vjetër dhe e degraduar ku në vende të caktuara mungon teresisht furnizimi. Autoritetet shtetërore nuk kanë mundur të bëjnë akoma një census të sakte për situatën ekzistuese të sistemeve të vjetra apo edhe atyre të reja kryesisht për shkak të instrumenteve monitoruese. Mesatarisht furnizimi me ujë behet 3-4 ore në ditë. Gjithashtu pushteti qendror



por edhe ai vendor kanë hasur vështirësi dhe nuk kanë pasur sukses në kontrollin e duhur të migrimit i cili vazhdon edhe sot në të njëjtën mënyrë.

Francesca Cesa Bianchi:

Mendoj që diskutimin ta fillojmë me një prezantim të shkurtër të pjesëmarrësve në këtë tavolinë. Po e filloj nga vetja, unë quhem Francesca Cesa Bianchi dhe jam pjesë e skuadrës së Stefano Boeri Architeti. Kam rolin e project leader për projektin e Planit të Përgjithshëm Vendor të qytetit të Tiranës. Sëbashku me Maria Chiara Pastore do të drejtojmë diskutimin e tryezës përsa i përket tematikës së infrastrukturës duke bërë disa pyetje thelbësore për të kuptuar sa më mirë situatën ekzistuese dhe ndryshimet që mund të sjellë ky plan i ardhshëm.

Francesca Cesa Bianchi:

Mendoj të biem dakord që të komunikojmë në gjuhën angleze në vazhdim të diskutimit tonë.

Arlind Okaj:

Gjithsesi mund të ndihmojmë njëri-tjetrin në qoftë se dikush ka vështirësi në të shprehur në anglisht.

Francesca Cesa Bianchi:

Propozoj që materialin dhe hartat që kemi përpara ti ndajmë bazuar në dy tipologji kryesore, menaxhimin e ujrave dhe menaxhimin e mbetjeve urbane. Në mënyrë që në fund të diskutimit të kemi një panoramë të përgjithshme të situatës ekzistuese. Gjithashtu duhet të punojmë për të sygjieruar një infrastrukturë që nuk bazohet vetëm tek mobiliteti dhe por edhe tek lidhja që kanë të gjitha rrjetet infrastrukturale me njëra-tjetrën.

Maria Chiara Pastore:

Mendoj që gjëja e parë që duhet të diskutojmë është uji dhe energjia, si bashkëveprojnë ato me njëri-tjetrin, sepse ne e dimë që në Shqipëri pjesa më e madhe e energjisë gjenerohet nga uji dhe hidrocentralet, apo jo?

Arlind Okaj:

Për sa i përket këtij sektor ai mbulohet nga pushteti qëndror dhe për më saktë nga Ministria e Energjitikës, por fatkeqsisht sot nuk kemi përfaqësues nga kjo Ministri. Është e vërtetë që thuhet se gjithë energjia që gjenerohet në Shqipëri vjen nga përdorimi i hidrocentraleve.

Maria Chiara Pastore:



Ok, të diskutojmë atëherë për projekte që po zbatohen apo priten të implementohen nga Bashkia Tiranë, që patjetër kanë lidhje dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në rrjetet infrastrukturore. Te kombinojmë të gjitha vlerat dhe kapacitetet e mbledhur ne tryezë që të kemi një output sa më të mirë për këtë faze të projektit.

Erindi Bejko:

Mendoj se tryezës i mungon drejtori i përgjithshëm i UKT sepse është ai që mund të na jepte informacione më të hollësishme për problemin në fjalë. Ne kemi përgjegjësi vetëm për pjesën e projekteve dhe ne nuk i kemi kapacitetet dhe kopetencat për rrjetin e ujrave nëntokësor.

Robert Mancellari:

Si Drejtori e Planifikimit të Punëve Publike në Bashkinë e Tiranës, objekt kryesorë kemi ndërhyrjen në infrastrukturën rrugore dhe në kuadrin e ndërhyrjeve inxhinjrike rrugore përfshihen kanalizimet e ujrave të bardha dhe të zeza, ujësjellësi dhe rrjetet e internetit, telefonisë që së fundmi po kalohen nëntokë. Kjo për sa i përket zonave të urbanizuara, për zonat rurale problemi është më i thjeshtë pasi aktualisht nuk hyet kaq në detaj për këto rrjete të infrastrukturës.

Francesca Cesa Bianchi:

Për të ndjekur axhendën dhe për të kuptuar të dhënat, ne jemi të interesuar kuptojmë se çfarë është për ju ndryshimi i kufirit të Bashkisë Tiranë. Cilat janë të dhënat që ju keni për këtë çështje?

Robert Mancellari:

Aktualisht nuk kemi të dhëna të sakta për zonat e bashkëngjitura, ish-komunat, tani ka filluar inventarizimi.

Arlind Okaj:

Desha të diskutoj pak, me që u hap kjo temë, për çështjen e të dhënave për sa i përket pjesës së qytetit të Tiranës, ose me mirë për Bashkinë e Tiranës së vjetër. Bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të kaluar hartat që kemi pasur në dispozicion për sa i përket infrastrukturës dhe rrjeteve inxhinjrike, i merrnim vazhdimisht si të mirëqëna. Pyetja që dua të shtroj është se kur ka qënë hera e fundit që ky material hartografik është update-nar?

Robert Mancellari:

Atëherë praktika është e tillë, për investimet e reja që bëhen merren axhomimet e rrjeteve ekzistuese. Për këtë ka një drejtori në Bashki, Drejtoria e Rrjeteve Inxhinjrike, dhe ato në bazë të planit ku do ndërhyet japin të dhëna të azhornuara. Por një hartë të mirëfilltë të azhornuar dhe të përmbledhur nuk ekziston.

Francesca Cesa Bianchi:



Mendoj se kemi kapur pikat e duhura për tematikën e tryezës, duke diskutuar kështu problemet konkrete që ballafaqohemi gjatë planifikimit. Pasi ne jemi të interesuar të dimë se si do të menaxhohet territori i zgjeruar tashme i Bashkisë Tiranë.

Dritan Bratko:

Me lejon të shpjegoj disa pika kryesore. Atëherë, ne kemi Tiranën e cila shtrihet midis dy baseneve të mëdha ujore, lumit i Ishmit dhe lumit Erzeni. Në këto dy lumenj shkarkohet pjesa më e madhe e ujrave të Tiranës, duke perfunduar më pas në det. Besoj se duhet të analizojmë cilat janë pikat kritike të këtij sistemi drenazhimi. Një pikë tjetër është patjetër edhe situata e kanalizimeve të ujrave të zeza, të cilat nuk janë të ndara nga kanalizimet e ujrave të tjerë. Pika e tretë është për sa i përket ish-komunave ose njësisive të reja administrative është se si do të lidhet dhe unifikohet rrjeti i tyre i kanalizimeve me Tiranën. Pra bazuar në këto tre pika mendoj se zgjidhja sa do pak e tyre mund të ishte një fillim i mirë për zgjidhjen e problemit në tërësi. Vlerësoj problematikën që ngriti edhe Arlindi duke qënë se të gjithë e hasim mungesën e materialeve të përditësuar hartografike. Aktualisht unë po punoj me një projekt për sa i përket kanalizimeve të ujrave të bardha midis Tiranës dhe Durrësit dhe kur kërkoj informacion në Bashkitë përkatëse, ai ose mungon ose është i papërditësuar. Pra na duhet të kemi të dhëna më aktuale.

Marla Chiara Pastore:

Le të kthehemi edhe një herë diskutimit të mëpërparshëm. Me sja po kuptoj ka një rrjet të tubacioneve për grumbullimin e ujrave, kush është përgjegjës për këtë rrjet për sa i përket investimeve mirëmbajtjes etj...

Dritan Bratko:

Rrjeti i kanalizimeve është pronë e Bashkisë Tiranë.

Namik Simixhiu:

Është SH.A nuk është plotësisht pronë e Bashkisë.

Erindi Bejko:

Bashkia e Tiranës është aksioneri kryesor në këtë rrjet.

Henrik Hysenbegasi:

Tirana është sot 25 herë më e madhe dhe për sa i përket rrjeteve të kanalizimeve, Bashkia e Tiranës është aksioneri kryesor në këtë marrëdhënie. Pjesa tjetër plotësohet nga disa kompani të tjera privat. Problemi kryesor të cilin e përmendi edhe inxhinjeri pak më parë është përzjerja që ndodh midis ujrave të bardha dhe



atyre të zeza. Po ndërtohet impianti i trajtimit të ujrave në bashkëpunim me J.I.C.A i cili ndodhet pranë Kasharit dhe dy projekte paralele po implementohen për sa i përket kolektorëve.

Maria Chiara Pastore:

Pra këto kolektorë po ndërtohen për pjesën e qytetit të Tiranës duke marrë parasysh edhe pjesën e shtuar të ish komunave?

Henrik Hysenbegasi:

Jo, pikërisht këtu hasim edhe problemin më të madh. Kryesisht gjëndja më kritike është në pjesën me densitet të lartë. Ajo çfarë po përpiqemi të bëjmë është të ofrojmë rrugë automobilistike dhe shërbime bazë në këto njësi administrative si për shëmbull lidhja me linja të reja autobus. Gjithashtu po përpiqemi të zonat me përdorim natyror duke synuar intensifikimin e zonave afër qendrës dhe zëvendësuar objektet e degraduara me ndërtime të reja. Rrjedhimisht dy problemet kryesore që na dalin janë menaxhimi i mbetjeve urbane dhe ujësjellës kanalizimet. Për sa i përket ujësjellësit mendoj se është më pak kritike sepse fatmirësisht ne kemi përreth Tiranës liqene të ngritura në kuotë. Pak vite më parë Alberto, i cili është i pranishëm në sallë, sëbashku me studion Grimshaw kanë punuar mbi projektin e ujrave të zeza i financuar nga qeveria e Abu Dhabi-t. Projekti konsiston në ndërtimin e 2 kolektorëve të mëdhenj afër malit të Dajtit. Dhe gjithashtu ndërtimin e dy kolektorëve përgjatë lumit të Lanës të cilët do të arrijnë deri në impiantin e trajtimit në Kashar. Po flasim gjithmonë për kanalizimet e ujrave të zeza. Ne po përpiqemi të mbulojmë pjesën e densifikuar të qytetit sepse sot për sot ne akoma kemi ujrat e zeza të cilat bashkohen me ato të bardha pa u trajtuar. Gjithashtu as ish-komunat nuk kanë rrjet të mirë të kanalizimeve të ujrave të zeza, kush e di disa edhe kanë.

Maria Chiara Pastore:

Për momentin ato shkarkojnë në lumenj?

Henrik Hysenbegasi:

Po për momentin po.

Maria Chiara Pastore:

Po për sa i përket ujësjellësit, pjesja më e madhe arrihet nëpërmjet rrjetit të qytetit, a ka puse që operojnë?

Henrik Hysenbegasi:

Po ka shumë puse, kurse tubacionet janë instaluar shumë vite më parë dhe rinovohehen kur është e nevojshme nga drejtoritë përkatëse. Tirana ka pasur vazhdimisht probleme me furnizimin me ujë këto 25 vite, por tashmë gjëndja është më e mirë dhe vazhdon të përmirësohet nëpërmjet projekteve të ndryshme që mundësohen nga taksat e qytetarëve apo edhe nga investime të huaja.



Marla Chiara Pastore:

Në qoftë se po themi se ka puse uji, a gjënden ato në qytet apo jashtë tij?

Henrik Hysenbegasi:

Janë të shpërndarë, gjithandej.

Maria Chiara Pastore:

A janë informale, a paguajnë njerëzit për to?

Arlind Okaj:

Edhe puset janë detyrim të paguhen, por një pjesë e madhe e tyre janë informale.

Maria Chiara Pastore:

Pra Bashkia është përgjegjëse për puset e ujit, a kenë një hartë të vendndodhjeve të tyre.

Arlind Okaj:

Jo, ne dijeninë time bashkia nuk ka.

Francesca Cesa Bianchi:

A ka monitorim të cilësisë së ujit?

Namik Simixhlu:

Po edhe puset private duhet të kenë analiza të cilësisë së ujit nga insituet përkatëse, të cilët vendosin në qoftë se mund të përdoret për t'u pirë apo për nevoja të tjera. Nga harta e ujësjellësit mund të kuptojmë se Tirana ka 5 burime kryesore të ujit, ai i Bovillës, Burimet e Shën Mërisëafër malit të Dajtit, Bërxullës, Selitës dhe i Laknasit. Por këto furnizojnë vetëm qytetin e Tiranës, për pjesën tjetër të ish-komunave ose duhen bashkangjitur këtij rrjeti ose kanë burimet e tyre.

Maria Chiara Pastore:

A paguajnë qytetarët për ujin apo është falas?



Namik Simixhiu:

Po paguajnë

Maria Chiara Pastore:

A është tarifë fikse apo paguhet në bazë të konsumit?

Arlind Okaj:

Për ato të cilët kanë sahat paguajnë në bazë të konsumit, pjesa tjetër paguajnë aprobe.

Namik Simixhiu:

70% e qytetit të Tiranës është e pajisur me sahatë për matjen e konsumit të ujit, dhe konsumatorët i paguajnë UKT-së. Mendoj se duhet kontaktuar me UKT për një informacion më të hollësishëm.

Henrik Hysenbegasi:

Aktualisht drejtoria jonë po menaxhon disa projekte shumë të rëndësishme të përfuara nga investimet e huaja, për shëmbull zgjatimi i bulevardit të Tiranës dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës. Gjithashtu edhe projekti i stacionit Multimodal që ndodhet në kthesën e Kamzës. Një projekt tjetër me rëndësi të vecantë është edhe ndërtimi i 16 shkollave të reja në 2-3 viteve të fundit. Te gjitha këto projekte dhe shumë të tjera financohen dhe mbështeten nga investimet e huaja.

Maria Chiara Pastore:

Pyetja që na lind këtu është cili është ndryshimi midis investimeve të huaja që vijnë nga ministrinë dhe atyre që vijnë direkt në bashki, a ndodh ndonjëherë të ketë mospërputhje nga këto institucione?

Erindi Bejko:

Detyrat janë qartësisht të ndara sepse Ministrinë kanë target tjetër dhe Bashkia ka target tjetër.

Arlind Okaj:

Ministrinë fokusohen kryesisht në investimet në nivel kombëtar.

Henrik Hysenbegasi:

Shpesh ka bashkëveprim midis Ministrive dhe Bashkisë sepse për shëmbull një rrugë kombëtare mund të kalojë pjesërisht në qytet, por sigurisht që nuk ka mbivendosje të investimeve të huaja.



Arllind Okaj:

Ne kemi mardhënie të mira gjithashtu me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve, i cili lëvront fonde nga buxheti i qeverisë për zhvillimin e projekteve të pushtetit vendor. Për shëmbull edhe pak po përfundon zbatimi i projektit të rehabilitimit të pazarit të ri dhe Sheshit Avni Rustemi. Gjithashtu pritet financimi i dy projekteve të tjera të rëndësishme sic është ai i parkut të Liqenit të Kasharit dhe fazës së dytë të Parkut Olimpi.

Marla Chiara Pastore:

Po flisnim pak më parë për rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza dhe thamë që për ish-komunat kemi një situatë të paqartë të gjëndjes ekzistuese

Dritan Bratko:

Pra sic e shikoni shumica e shkarkimeve të ujrave përfundon në lanë dhe më pas do të trajtohet nga impianti i trajtimit të ujrave.

Marla Chiara Pastore:

Dhe nga aty ku shkojnë?

Dritan Bratko:

Nga aty perfundojnë në Erzen, nuk jam i sigurtë.

Maria Chiara Pastore:

Sistemi është i miksuar apo është i ndarë, pra a do të ndahen ujrata e zeza nga ato të bardha përpara se të mbërrijnë në impiant?

Dritan Bratko:

Sistemi është i përzierë.



Robert Mancellari:

Aktualisht ku ka investime të kohëve të fundit kanalizimet janë të ndara por problemi është se ribashkohen prap në segmentet e tjera të rrjetit. Për sa i takon rehabilitimit të lumit të Tiranës parashikohet ndërtimi i dy kolektorëve në të dyja anët e lumit, njëri mbledh ujrë të Tiranës dhe tjetri ujrë të Paskuqanit.

Maria Chiara Pastore:

Pra ju po thoni që deri tani ujrë të zeza të Tiranës janë derdhur në lumenj, në cilë lumenj mund të më thoni?

Dritan Bratko:

Kryesisht në lumin e Tiranës dhe në Lanë

Robert Mancellari:

Pra po ju thoja për dy kolektorët që do të ndërtohen. Ato do të mbledhin ujrë nga veriu dhe nga jugu dhe vazhdojnë afërsisht deri tek kthesa e Kamzës dhe për të mos përfunduar direkt në lume janë parashikuar dy gropa septike. Kjo është faza e parë që ka gjatësi prej 7 km, ndërsa faza e dytë është në varësi të investimeve të ardhshme që do kemi.

Marla Chiara Pastore:

Të flasim pak për gjëndjen e mbetjeve të ngurta.

Namik Simixhiu:

Ateherë, qyteti është i ndarë në 6 zona për sa i përket mbledhjes dhe transporti të mbetjeve urbane, shërbimi ofrohet nga kompani të kontraktuara private. Aktualisht kemi vetëm një landfill, ai i Sharrës që ndodhet rreth 7 km larg qendrës së qytetit i ndërtuar mbase në vitin 1985. Ka disa projekte për përmirësimin dhe modernizimin e tij për të pasur një rendiment më të mirë. Gjithashtu së fundmi kemi nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi me qytetin e Veronës dhe shpresojmë të kemi impaktin e duhur. Sot për sot u shërbejmë rreth 650'000 banorëve me një sasi rreth 500-600 tonësh në ditë. Ndërsa për pjesën e ish-komunave të bashkëngjitura Tiranës nuk kemi akoma informacion.

Niko Pano:

Unë desha të ngrej pak problemin e të dhënave klimatike, sepse gjithmonë flasim për klimë gjeografike ndërkohë duhet të flasim edhe për klimë matematikore. Pikë së pari kemi mungesë të theksuar për sa i përket nivelit të reshjeve. Pika e dytë e rëndësishme është edhe hidrologjia e lumenjve. Duhet të dhenat bazë për prurjet maksimale dhe minimale të 4 lumenjve kryesorë të Tiranës, lumit të Erzenit, lumit të Ishmit, Lanës dhe lumit të Tiranës. Pa këto të dhëna mendoj se nuk mund të vazhdohet më tej. Gjithashtu na duhet një studim i nryshimeve klimatike për sa i përket impaktit që kanë direkt në ujë. Na duhet të kemi një monografi specifike për Tiranën, ne kemi një të tillë për të gjithë Shqipërinë që e kam publikuar, bile edhe në librin tim, kështu duhet ta kemi edhe vecanërisht për Tiranën për vec kësaj na duhet të kemi edhe një klimatologji



inxhinjerie, një hidrologji shkencore inxhinjerie që do i shërbejnë planifikimit urban të ardhshëm. Mendoj që duhen shfrytëzuar prurjet maksimale edhe për të gjeneruar energji elektrike por edhe për të minimizuar përmbytjet. Ne nuk kemi të dhëna të sakta statistikore mbase që nga viti 1990.

Francesca Cesa Blanchi:

Për momentin cilat janë pikat më kritike të përmbytjes në Tiranë?

Arlind Okaj:

Përgjithësisht shumica e zonave në Tiranë kanë probleme me përmbytjet afatshkurtra shkaktuar nga reshjet e dëndura. Kjo ndodh për shkak të sistemit të amortizuar të kanalizimeve që shpesh herë bllokohet dhe nuk përballon nivelet e larta të reshjeve. Por me specifike janë zonat përgjatë lumit të Tiranës të cilat bëhen më evidente për shkak të ndërtimeve informale të ndërtuara përgjatë.

Dritan Bratko:

Problem për këto zona është gjithashtu kuota e ulët në të cilat ndodhen dhe të gjitha ujrat që vijnë nga lart dhe që akumulohen aty. Pastrimi i këtyre lumenjve nga mbetjet do të ndihmonte shumë në zgjidhjen e problemit. Pra diçka tjetër që mund të bëjmë është zbardhja e këtyre vlerave dhe modelimi i prurjeve të lumenjve dhe të analizojmë kondicionet dhe veprimin e tyre në situata të ndryshme. Për sa i përket liqeneve, për shëmbull liqenit artificial të Tiranës, mendoj se duhen analizuar pikat maksimale të shkarkimeve dhe të merret parasysh mbase ndërrimi i kanaleve, sepse me sa jam unë në dijeni ka probleme me shkarkimin e prurjeve maksimale. Aktualisht mund të them që po punohet për rehabilitimin e pjesës perëndimore të lumit të Lanës gjithashtu është kontraktuar edhe pjesa lindore e tij.

SFIDAT KRYESORE:

- Implementimi i strategjise per basenet e lumenjve.
- Problemi i konsiderimit te lumenjve si "kolektore".
- 70 % i ujit te lumenjve eshte i ndotur.
- Identifikimi ne detaj i problematikave ne lidhje me ujesjelles-kanalizime me qellim permiresimin e tyre.

REPORT
TIRANA CALLING SMART CITY/COMMUNICATION
TAVOLINA nr. 4

PJESEMARRESIT

1. Francesca Rizzetto (UNLAB) kordinator
2. Paolo Vimercati (Grimshaë) kordinator
3. Eneida Berisha
4. Nada Ibrahim
5. Luiza Grazhdani
6. Ulrike Bega
7. Gjergji Dushniku
8. Besmira Dyca
9. Alda Zholi
10. Ana Toci
11. Ana Shpuza

Përmbledhje

- Mbledhja e informacioneve formale
- Mbledhja e të dhënave informale
- Kalimi nga problemet tek oportunitetet
- Qyetetarët aktivë: 1.mbledhja e informacionit 2.shpërmdarja e informacionit 3.të përdorurit e informacionit
- zvogëlimi i boshlliqeve të krijuara mes gjeneratave

SFIDAT

- Ekzistenca e informacionit i cili nuk dihet si të komunikohet
- Përdorimi efikas i burimeve ekzistuese
- efica
- përdoruesi <-> informacion (kornizë) <-> vendimmarrësi

OPORTUNITETE

- Frymëzime nga të tjerë paraardhës

- infrastruktura teknologjike të propozuara të cilat mund të shmangin problematika të cilat vëndet e tjera i kanë kaluar tashmë (të mësuarit nga gabimet e të tjerëve)
- Projektimi i së ardhmes
- Dëshira e njerzve për ndryshim
- Qytetarët: ofruesit e sistemit publik

PROJKTE

(informale)

- Milano – “Night hour” buses (Autobusët e orëve të vona)
- London –
 - 1.Johnny bus (GPS)
 - 2.Vrojtuesit e sistemit hekurudhor
 - 3.Shpërndarja e interesave
- Rotterdam –“Anti-Crack” system (Sistemi “Anti-Krack”)

Pyetje dhe çështje të hasura gjatë diskutimit:

Cfarë është një qytet Smart? Lidhet ky concept me teknologjinë? (F)

B: Smart- city lidhet me urbanizmin, komunikimin dhe mjedisin. Qyteti Smart është pak nga të gjitha.

Ka çështje të cilat lidhen me përhapjen urbane, migrimin, të ardhurit dhe komunikimi mund të shërbejë si një metodë përdorimi dhe burimi. Ajo eka mund të bëhet në ndihmë të këtyre rasteve është investimi publik.

P: Inteligjent si teknologjia, duke i dhënë mundësi përdoruesit të adaptojë Memorjen – Ekonominë – Katalogimin (në termat e katalogimit jo vetëm të ankesave por edhe të informacioneve të nevojshme)

AG: Të filluarit me sensibilizim e njerzve por jo duke i mësuar ata.

Gj: Qytetarët dhe përdoruesit të përdorin dhe shpërndajnë informacionin (p. sh Të gjeturit e parkimit dhe përhapja e informacionit në të tjerë)

P: Filtrimi i informacionit dhe ndërtimi i një sistemi të dhënash system (Austin USA, gjithcka gjëndet ne një sistem; Londër, UK: linja e autobuzëve, “Johnny bus” – vendndodhja e dhënë sipas një sistemi GPS)

B: Probleme si pasojë e një mungese komunikimi – nuk ka metoda të cilat i tregojnë njerzve ku të shkojnë.

GJ: Si mund ti bëjmë gjërat të funksionojnë kur informacioni nuk është i disponueshëm?

P: Shëmbull vrojtuesit e hekurudhave.

U: Qyteti inteligjent duhet parë jo në kuadrin e e matjes së çdo elementi por në termat e rritjes së eficeses.

Si të ndërtosh? Si të mbledhësh informacion?

N: Përdorimi i metodave inteligjente për të mbledhur informacion. Fillimisht ai të behët i aksesueshëm dhe pastaj të pretendohet përdorimi. Problematia fizike dhe teknologjike.

P/U: Filtrimi i informacioneve (informacion/nevoja/sygjerime)

U: Rreziku i rrjedhjes së informacionit – vendosja e informacioneve në vendin e duhur

L: Si mund të bëhen informacionet të aksesueshme edhe nga të moshuarjt?

Si të marrësh vendimin e duhur? Si të menaxhosh problemet? Si të marrësh vendime të zgjuara?

Lind nevoja e ndërmarrjes së një liste aksionesh të cilat duhet të funksionojnë në termat e ndryshimit të sjelljes së qytetareve në lidhje me qytetin duke i krijuar atyre mundësinë të ndihen si qytetarë.

Shëmbuj:

Londër – interes për të ndarë problematikat lokale

Rotterdam – sistemi “Anti-Crack”, personat që duan të marrin më qëra një objekt të braktisur duhet të kujdesen në shkëmbim për të.

Italy/ Milano – “Night Hour”, linja e urbanëve të cilët sigurojnë transportin edhe gjatë natës.

RAPORT
TIRANA CALLING /KULTURA
TAVOLINA E RRUMBULLAKËT 2

PJESËMARRËS:

Gjergj Papavasili	Bashkia Tiranë
Valter Gjoni	Bashkia Tiranë
Edit Pula	Bashkia Tiranë
Besim Petrela	Bashkia Tiranë
Frida Pashako	Bashkia Tiranë (Kordinatore)
Sonila Kapidani	Bashkia Tiranë
Vitna Hodo	Bashkia Tiranë
Tommaso Sacchi	Stefano Boeri Architects (Kordinatore)
Stefano Romano	Stefano Boeri Architects
Melania Keçi	Stefano Boeri Architects
Iris Baboci	Bashkia Tiranë
Romeo Kodra	Tirana Art Lab
Jola Mekollari	Bashkia Tiranë
Ina Haveri	Bashkia Tiranë

PËRMBLEDHJE: Kultura

Objektiva:

- Pasqyrimi i jetës kulturore në Tiranë
- Përcaktimi i institucioneve kulturore të të gjitha llojeve në Tiranë,
- Hapësirat e hapura të përshatshme për aktivitete kulturore.
- Problematika të jetës kulturore dhe institucioneve kulturore në Tiranë.
- Propozime në lidhje me hapësirat e aktiviteteve kulturore që duhet të merren parasysh në planin e ri të përgjithshëm vendor

Panoramë e shkurtë e historikut të zhvillimit të jetës kulturore në Tiranë, dhe institucioneve kulturore në Tiranë, jo vetëm ato të tipit opera, por dhe ato që formojnë agregacione kulturore të indit qytetar.

Kultura në vitet '20-30 (zhvillohet, filmi, fotografia, grupimet e vogla artistike)

Kultura në vitet '40 (7 kinema, sallë teatri)

Kultura në kohën e komunizmit(lëvizje artistike e shumëllojtë, por me një orientim, realizmin socialist)

Kultura pas viteve '90 deri sot: institucionet kulturore shumica e tyre janë jashtë juridiksionit të Bashkisë së Tiranës. Tirana, vuan për një identitet kulturor të sajën, edhe pse ka pasur shumë resurse dhe tradita të sajat (panairi i Shën Lleshit, ka shumë studio piktorësh me traditë).

Në territorin e ri të administruar nga Bashkia Tiranë, përfshihen dhe ish komunanat e Bashkisë Tiranë. Riorganizimi i ri ka synim rigjallërimin e jetës kulturore të Tiranës,

Tirana ka shumë monumente të kulturës të kategorive të ndryshme. Së fundmi janë shpallur monumente kulture, 3 ish – zona industriale .

Para viteve '90 çdo lagje e qytetit kishte shtëpitë e kulturës.

Pjesa më e madhe e insitucioneve të kulturës janë ndërtuar para viteve '90.

Bashkia e Tiranës po përpiqet për të mbushur verën e Tiranës nga qershori në tetor me aktivitete artistike, si festivali i filmit, i xhazit, i teatrit të rrugës, dhe këto të lokalizuara jo vetëm në gjithë Tiranën, te Ali Demi, Kombinat, njësitë e reja administrative.

Problematika:

Jeta kulturore zhvillohet vetëm në qendrën e Tiranës.

Pjesa më e madhe e insitucioneve të kulturës janë ndërtuar para viteve '90.

Në juridiksionin e bashkisë së Tiranës është Teatri i Metropolit.

Tirana nuk ka një galeri të miëfilltë për artin bashkëkohor.

Ka munguar transparenca në lidhje me aktivitetet kulturore dhe mënyrën e aplikimit për to.

Gjatë 25 viteve të fundit qyteti është zgjeruar në mënyrë të ndjeshme por duke ndërtuar kryesisht banesa dhe ambiente tregtare, fare pak objekte ekonomike dhe pothajse aspak objekte sociale dhe kulturore.

Ka shume pak ambiente për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

Objektet kryesore kulturore si muzetë, biblioteka, pallati i kulturës, teatrot, kinematë, etj. nuk funksionojnë me kapacitetin e tyre të plotë dhe aktivitete në to janë të pa organizuara.

Propozime:

Me ndarjen e re administrative Tirana përfshin një territor shumë të madh i cili ka kryesisht karakter rural. Jeta kulturore është e përqëndruar vetëm në qendrën e qytetit. Periferia, (ish komunat) nuk kanë aktivitete të kësaj natyre.

Zhvillimi i qytetit në të ardhme do të ketë karakter policentrik me qendra të shpërndara në mënyrë uniforme.

Këto qendra duhet të kenë karakter polifunksional dhe përveç shërbimeve të përfshijnë edhe shumë element me karakter kulturor.

Duhet të ketë qendra kulturore të cilat të përmbajnë salla koncertesh, ekspozita, galeri, biblioteka, salla konferencash, teatro, në çdo zonë, por sidomos jenë të shpërndara në periferi.

Qyteti duhet të ketë zona muzeale polifunksionale në zona të ndryshme ku të evidentohen vlerat historike, folklorike dhe kulturore për secilën zonë në veçanti të qytetit (me elementë karakteristike të këtyre zonave)

Gjatë zhvillimeve të vullëshme dhe kryesisht atyre informale të viteve të fundit, ka humbur kujtesa e qytetit. Duhet të vlerësohet kjo kujtesë duke kthyer disa zona, objekte ose elementë të veçantë në identitet.

Duhet të ketë zona muzeale me banesa karakteristike të cilat të mbrohen me rregullore dhe kritere shumë rigorozë.

Në disa zona duhet të krijohen qendra të mëdha panairësh për libra, filma etj. për të cilat ka shumë nevojë qyteti, si dhe të krijohen salla dhe ambiente polifunksionale.

RAPORT
TIRANA CALLING MOBILITY
TAVOLINA 5

PJESMARRËS

1. Edmond Alite
2. Arben Biçoku
3. Shpresa Leka
4. Alban Eftimi
5. Kreshnik Bajraktari
6. Dede Shkurti
7. Anthim Vjero
8. Anisa Stasa

Diskutimin e vazhdueshëm dhe aktiv me temë *Mobility/Lëvizshmëria* mes ekspertëve të fushave përkatëse e nisi **Z. Arben Biçoku**, i cili propozoi që ai të shtrihet në 3 plane:

- Zhvillimi historik dhe analiza e gjendjes ekzistuese
- Evidentimi i problemeve
- Sugjerime për zgjidhjen e tyre

Tirana është qytet që rrugët i ka të zhvilluara me plan. Plani i 1-rë e pati zgjidhur mirë sistemin rrugor në Tiranën e re dhe në pjesën ekzistuese të qytetit". Plani i vitit 1940 është ndjekur nga ai i 1957-ës, i njohur si plan decentralizues, pasi krijoi qendra të reja si ajo e Kombinatit, Laprakës, Kinostudios dhe Autoktaktorët. Një tjetër plan ishte ai i vitit 1990, me afat 15 vjeçar. Ky ishte një plan ligjor dhe është përdorur deri në vitin 2013.

Një tjetër problem i ngritur nga z.Biçoku ishte ai i trafikut në orët e pikut. Në planet rregulluese të 1940-ës, 1950-ës dhe 1990-ës zonat e punës ishin të mirëcaktuara, rrjedhimisht dhe destinacionet e lëvizjeve. Sot duhen bërë efçente dhe zona të tjera, kurse zonat e punës që s'krijojnë ndotje duhen alternuar me zonat e banimit. Gjithashtu sipas normave urbanistike, sipërfaqja e sistemit tonë rrugor është nën ato të duhurat.

Sipas **Znj. Leka**, çështja e mobilitetit duhet të mos kufizohet rreth Planit Rregullues, por të diskutohet për Tiranën e madhe. Ajo u shpreh se:

- Duhet krijuar sfida dhe stabilitet për territoret e ish komunave.
- Infrastruktura ka ndikimin kryesor në lidhjen e qytetit me ish komunat.

- Rëndësi i duhet kushtuar legjislacionit, normave dhe kushteve. Nëse standartet janë të respektohen, nëse jo, të vendosen. Makinat, biçikletat dhe njeriu duhet të jenë thelbi i kodit rrugor.
- Korsia e biçikletave duhet vendosur aty ku është e mundur.
- Rruga duhet të jetë promotori i zhvillimit të zonës, ndaj skema e qarkullimit të jetë sa më produktive.
- Zona ku të shtrihet rrjeti rrugor të jetë e gjeoreferencuar”.

Një tjetër sfidë është parashikimi i buxhetit për skemat e lëvizjes. Është më e nevojshme përmirësimi sesa krijimi nga e para, si dhe të shfrytëzohen sistemet rrugore të studimeve pjesore të mëparshme.

Plani duhet ti japi rëndësi transportit publik të lëvizjes urbane, të zgjerohen korsitë e rrugëve duke bërë shpronësime. Lidhja e zonave periferike me qendrën është e rëndësishme, por studimi duhet të shohi dhe mudësinë e lidhjes së ish komunave me njëra tjetrën. Pra të propozohet një tjetër unazë duke iu referuar këtyre qendrave të banuara që do jenë pjesë e qytetit.

Për realizimin në kohë të projekteve, **Z. Vjero** propozoi aplikimin e gjobave në rast mos respektim afatesh, si dhe të punohet me kapacitet të plotë.

Z. Edmond Allte citoi se vizioni i gjithë projekteve për Tiranën ka qenë tia kthejnë qytetin njeriut. Trotuarët janë të rëndësishëm, këtu duhet të nisë mobiliteti.

Për zgjidhjen e këtyre problemave ai sugjeron:

- Bërjen e shpronësimeve,
- Ndërtimin e mbikalimeve apo metro.
- Gjithashtu i duhet dhënë më shumë përparësi transportit publik (si dhe korsive të dedikuara të tyre) pasi ka më shumë produktivitet, zë më pak vend dhe ndot më pak.
- Nga statistikat rezulton se 50% e lëvizshmërisë është këmbësore dhe 30% lëvizje me automjete.
- Trotuarët duhet të jenë të lehtë aksesueshme dhe nga njerëzit me aftësi të kufizuara, dhe nëse gjerësia e tyre nuk është optimale të mos mbillen pemë në to, pasi i ngushtojnë së tepërmi dhe ulët komoditetin në lëvizje.

Ndërsa sa i përket trafikut, faktorët që do të ndikojnë në uljen e tij janë:

- Unaza e madhe dhe ajo e vogël,
- Krijimi i disa stacioneve multimodale, (jo vetëm ai i Kasharit që të mos përqëndrojë trafikun).
- Evitimi i parkimit anësor sjell zgjerimin e korsive.

Problem paraqesin gjithashtu zonat e banimit, ndaj i duhet kushtuar vëmendje unazave të vogla dhe të ndërmjetme, pasi aksesit i banorëve aty është i drejtpërdrejtë. Ato duhet të lidhen direkt me njëra tjetrën, dhe jo nëpërmjet qendrës.

Tirana Parking është një sfidë sot. rrugët urbane në Tiranë dhe Shqipëri nuk janë projektuar. Një projekt rruge ka të paktën 20 elemente. Rrugët sot janë ngushtuar nga bizneset e vendosura anës tyre, s'ka sinjalistikë dhe standarte të duhura. Tjetër problem i ngritur nga **Z. Shkurti** ishte dhe ai i parkimeve, sidomos në unazë. Hartuesit e politikave të transportit duhet të bashkëpunojnë me arkitekt dhe urbanist në realizimin e projekteve të rrugëve sipas standartit.

Qyteti i së ardhmes, sipas **Z. Eftimi**, duhet:

- Ti japi rëndësi njeriut, biçikletave, gjelbërimit dhe transportit publik.
- Duhet shmangur trafiku drejt qendrës dhe të krijohet mundësia e lënies së makinave në periferi.
- Trasetë e rrugëve të përcaktohen që të mos prishin parqet dhe zonat e gjelbëruara si dhe të ketë një balancim midis hapsirave të gjelbëruara dhe sistemit infrastrukturor.
- Të ulët Ksh (koeficienti i shfrytëzimit të tokës) për ndërtim në mënyrë që të ketë më shumë hapsira për rrugë dhe sheshe.

Gjithashtu policentrizmi i qytetit është i rëndësishëm, ndaj Bashkia e Tiranës duhet të promovojë dhe zonat larg qendrës.

RAPORT Mjedisi
- Ky model të aplikohet dhe në zona të tjera, në shkallë të ndryshme në varësi të zonës duke bërë të mundur krijimin e rrjetit të artit dhe kulturës, në mënyrë që arti dhe kultura të shkojë në çdo lagje të qytetit të Tiranës.
- Përsa i përket turizmit, Tirana ka potenciale të mëdha turistike, sidomos tani që në territorin e saj janë dhe ish komunat, ku secila prej tyre ka identitetin e saj kulturor, monumentet e trashëgimisë kulturore, si Kalaja e Petrelës, Kalaja e Dorzit, Kalaja e Prezës, Kalaja e Tiranës si dhe monumentet e kulturës të kategorisë së parë dhe të dytë të në të gjithë territorin e Tiranës.
- Vazhdimësia e projektit të fasadave "Ngjyrat e Tiranës", e cila bën të mundur krijimin e një trajektoreje interesante turistike, por në të njëjtën kohë do të nxisë dhe promovojë artistët shqiptarë.
- Arti në shkollë dhe hapja e shkollave për komunitetin një iniciativë e mire, por duhen përzgjedhur me kujdes programet kulturore artistike në shkollë dhe në ambientet sportive të tyre, në mënyrë që ato të mos ndikojnë në programin e shkollës. P.sh në këto shkollë pas orarit mësimor mund të ofrohen kurse të ndryshme me fokus programet mbi artin dhe kulturën jo vetëm për nxënësit e këtyre shkollave, por edhe për banorët e komunitetit që jetojnë përreth këtyre shkollave, ose aktivitete të ndryshme kulturore artistike për komunitetin .
- Unaza e katërt e konceptuar si një korridor i gjelbër shumë bukur mund të konceptohet si dhe korridori i artit bashkëkohor .
- Të përcaktohen në rregulloren e planit standarte për artin dhe kulturën, standarte të tilla si kinema/banorë, qendra kulturore/banorë.
- Tirana qytet ndërkombëtar. Arti, kultura, kanë fuqinë ta kthejnë Tiranën në një qytet ndërkombëtar. (Bialja e Tiranës ,një nga aktivitetet më të mëdha të artit në nivel ndërkombëtar).
- Paralel me planin rregullues duhet të hartohet dhe politika e zhvillimit të turizmit.



BASHKIA
TIRANË

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

TAKIMI	
DISKUTIME TE HAPURA	
QËLLIMI:	KËSHILLA DHE VIZIONE NGA EKSPERTË
Procès-verbal i datës:	021/06/2016
Vendndodhja:	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT Hotel The Plaza Tirana

PJESMARRËS NGA BASHKIA E TIRANËS:

Tavolina: City Zoning and
Regulations 1

Ilir Bejleri	Arkitekt			
Ariela Kushi	Eksperte Planifikimi			
Zenel Bajrami				
Besmira Dyca	Bashkia Tirane			
Flogert Lila	Njësia Administrative Kashar			
Andreas Faoro	UNLAB			
Devis Agaraj	Bashkia Tirane			
Adela Faruku	Bashkia Tirane			
Gjergji Papvasli	Bashkia Tirane			
Mirlinda Shqarri	Bashkia Tirane			

Flogert Lila solli disa shqetësime në lidhje me Njësine administrative Kashar:

1. *Rrjeti rrugor* - Si parashikohet lidhja e qytetit me njësitet e tjera? Njësia Kashar ka një mungesë të rrjeteve rrugore që e lidhin atë me qytetin.

2. *Metrobosco* - ku pikërisht parashikohet ky park për zonën e Kasharit? Cfarë

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

Sektorët e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit

sugjerohet për integrimin në Planin e ri të dy parqeve të parashikuara në këtë Njësi? Si mund të menaxhohen pronësitë në këto zona në mënyrë që të ndërtohen parqet?

3. *Shkollat* – Të shihet mundësia e integritit të 16 zonave që janë të parashikuara dhe të dedikuara për shkollat në Njësinë Kashar.

4. *Parku Olimpik* - A ka një zonë në Planin e ri që parashikon ku duhet të jetë një park olimpik?

Konsulenti i UNLAB deklaroi se Metrobosco nuk është një linjë e ngurtë kështu që aty mund të ketë ndryshime. Ai funksionon si një proces produktiv ku mund të kenë ndërtesa brenda, por me një intensitet shumë të ulët.

Strategjia është të realizohet brenda qytetit një kurorë e gjelbër që rrit numrin e pemëve përgjatë rrugëve.

Të përcaktohen mekanizmat e përshtatshëm për zbatimin e shtyllës së gjelbër - nga liqeni Artificial në liqenin e Paskuqanit.

Zhvilluesit që punojnë në zona të mëdha të marrin bonuse.

Të ri- investohen bonuset në hapësira të gjelbra.

Z. Devis Agaraj sugjeroi se rregullat janë të nevojshme për të balancuar marrëdhëniet midis hapësirës së ndërtuar dhe atë natyrore, duke u përpjekur të nxitet rihvillimi i mjedisit natyror në afërsi të qytetit ekzistues.

Znj. Besiana Dyca tha se në vende si Shqipëria është shumë e vështirë të sigurohen hapësira publike pa një faturë shumë të lartë financiare. Një pronë mund të jetë private, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të aksesohet nga publiku.

Ky park metropolitane do të mund të zbatohet duke përdorur pronën private, duke e vënë atë në dispozicion të publikut pa ulur vlerën e pronës; pa hequr të drejtat e pronësisë nga pronari, por përmes rregulloreve që do e orientojnë atë si të bëjë përdorimin e pasurisë së tij. Nga ana tjetër e ofrojnë këtë pronë si një e mirë që mund të gëzohet nga komuniteti.

Për shembull, në periferi ku prona nuk është zhvilluar ende është e hapur për diskutim se si ajo mund të përdoret. Bashkia gjithashtu ka bazën ligjore për ta bërë këtë.

Adreas Faoro theksoi se kjo është arsyeja pse projektet pilote janë mjete të rëndësishme për të provuar nëse këto gjëra funksionojnë, apo jo.

Z. Zenel Bajrami ndërhyri në lidhje me projektet pilote duke marrë parasysh disa skema si për shembull në projektin Grimshaw, i cili jep një ide në lidhje me instrumentet ligjore dhe si aktorët punojnë së bashku.

Ai pyeti në lidhje me ndryshimet në projektin Grimshaw, nëse ka ndonjë rregullore të fundit dhe çfarë solli nevojën për këto ndryshime.

Këshilltari shpjegoi se nuk ka një skemë përfundimtare ende. Ndryshimet janë bërë për të parë mundësinë e një intensiteti më të lartë dhe me qëllim që të ndërhyet më pak në zonat përreth, gjë e cila ngadalëson procesin e transformimit të qytetit ekzistues.

Kjo i lejon këtë zona të fillojnë procesin e krijimit të hapësirave dhe ndërtesave cilësore.

Ariela Kushi theksoi këto dyshime:

- E ardhmja e ekonomisë së qytetit. Çfarë do të ndodhë në korridorit ekonomike? A ka nevojë Tirana të ketë kontroll mbi këto zona?
- A do të ketë projekte pilote jashtë zonës së urbanizuar?
- Si do të integrohet Metrobosco me getot e Farkës, Dajtit dhe Kasharit?
- Duke u përballur me një rregullore të re që përmban distanca të tjera dhe përdor zhvillimin e disa zonave për të zbatuar dhe përmirësuar cilësinë, si do qasen distancat në strukturën ekzistuese urbane?
- Lidhja e zonave që transformohen me rrjetët rrugore. Si do të jetë i lidhur qyteti? Po Kashari me Tiranën?
- Ish-zonat industriale që janë brenda qytetit. Çfarë do të ndodhë me ta?
- Unazat - janë me të vërtetë të nevojshme dhe çfarë do të ndodhë me ta në veçanti me unazën e Katërt?
- Në Unazën e Pestë, a është i nevojshëm segmenti perëndimor, apo është më shumë një pengesë për Metrobosco-n? A është e nevojshme që të ketë një unazë apo majfton një ndërhyrje me bypass-e?

Ndërsa Z. Zenel Bajrami theksoi këto klauzola:

- Mund të parashikohen zona të veçanta brenda qytetit ku mund të zvogëlohen disi distancat dhe të rriten në disa të tjera.
- Intensifikimi në qendër të Tiranës është një prej armëve që keni për të mbështetur idenë e distancave.
- Lidhja e Metrobosco-s me zonën e Kasharit është problem sepse ajo ndërhyr me zonën ku plani i Kasharit parashikon të ndërtohet. Duhet të vendosen kufij në këtë Metrobosco, jo në formë linje, por në formë sipërfaqeje.
- Kashari është parashikuar si një qendër e re për qytetin. A do të konkurrojë ajo me 5 qendrat e tjera të parashikuara të zhvillimit?
- Një problem tjetër është rruga e re kombëtare që kalon nëpër Kombinat dhe Ndroq, sepse ajo do të ndikojë disi në vizionin tuaj.
- Duhet të keni një numër mekanizmash, por në aspektin e menaxhimit të tokës, nëse ju mund të vendosni rregulla të qarta dhe të detajuara se si mund të punojë intensiteti bonus, do të jetë më mirë.
- Duhet të merret në konsideratë se çfarë do të ndodhë në Paskuqan dhe Kamëz, sepse kjo do të krijojë probleme nëse zhvillimi kryhet në një mënyrë të ndryshme atje.

Znj. Besmira Dyca shtoi se:

Duhet të tregohet shumë të kujdes me planifikimin e banimit për nevojat e 15 viteve të ardhshme, në mënyrë që të mos shkaktohen probleme në tregun e shtëpive.

Gjithashtu duhet të merren në konsideratë ku do të pozicionohen nkrëkesat e reja për zhvillim brenda qytetit.

Z. Andreas Faoro sqaroi këto pika:

- Intensiteti është diçka që duhet të kuptohet me kujdes. Ribalancimi i intensitetit do të thotë ndërhyrja në mënyrën e duhur në përcaktimin e njësive strukturore.
- Qëllimi i Metrobosco është që në vend të zgjerimit të qytetit, të investohet në të për të rritur standartet.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

Sektoret e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit

- Popullsia e Tiranës nuk është rritur më, kështu që nuk parashikohet nevojë e madhe banimi në 15 vitet e ardhshme. Pse të mos investohet fillimisht në një qendër më të jetueshme ndërkohë që ndërhyhet me disa balancime jashtë.
- Nuk ka standarde për tërmetet dhe shumë gjëra të tjera. Kjo është një çështje e të kuptuarit prioritetet.
- Potenciali është të rishikohen vlerat shoqërore në drejtim të shkollave profesionale; ri-investimit në kapitalin njerëzor.
- Unaza e IV nuk është menduar për transport publik momentalisht. Qëllimi është ti jepet qytetit një hapësirë e gjelbër për këmbësorët dhe biçikletat.

Ai gjithashtu ngriti pyetjen se cilat janë zonat brenda dhe jashtë qytetit që qytetarët mendojnë se janë prioritet për ndërhyrje.

Z. Devis Agaraj donte të përmendte faktin se ne nuk duhet të themi intensifikimin, por normalizimin e qytetit ekzistues, sepse Tirana nuk është një qytet i dendur. Ai gjithashtu theksoi se pëlhura në strukturën urbane do të stimulohet. Në varësi të strukturave të reja urbane, do të krijohen rregulla të reja. Bashkia është duke përgatitur rregulla për të përmirësuar këtë proces në mënyrë që të lehtësohen gjërat.



BASHKIA
TIRANË

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

LAKIMI

DISKUTIME TE HAPURA

QELUMI:

KËSHILLA DHE VIZIONE NGA EKSPERTË

Procès-verbal i datës:

21/06/2016

Vendndodhja:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Hotel The Plaza Tirana

PJESMARRËS NGA BASHKIA E TIRANËS:

Tavolina: mobiliteti

Edmond Alite	Inxhinjier transporti			
Francesca Cesa Bianchi	SBA architect			
Gentian Muca	Inxhinjier Infrastruktura	gentian.muca@gmail.com		
Kreshnik Bajraktari	Bashkia Tiranë			
Gjergj Bakallbashi	Bashkia Tiranë	gjergj.bakallbashi@tirana.al		
Elios Kovaci	Bashkia Tiranë	elios.kovaci@tirana.al		
Klaudio Cari	Bashkia Tiranë	Klaudio.cari@tirana.al		
Soviela Shehu	Bashkia Tiranë	soviela.shehu@tirana.al		

Vizioni për mobilitetin në TR030 është për një sistem lëvizjeje që i lejon qytetarët të lëvizin në të gjithë qytetin në mënyrë sa më të sigurt dhe të qëndrueshme.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
Sektorët e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit

Prioritetet do të shpërndahen :

- Këmbësorë
- Bicikleta
- Transport public
- Transport mallrash
- Makinat
- Parkimi.
- Duke qenë një qytet policentrik duhet patjetër të kemi një transport public me një network të fuqishëm dhe të shpeshtë. Është shumë i nevojshëm një transport i shpejt dhe kjo kërkon që të kemi korsinë e dedikuar dhe të shtrirë në të gjithë zonat, të këtij transorti urban. Dhe kështu do të arrijmë që transporti public të jetë më terheqës nga përdorimi i makinës.

Gjithashtu edhe linjat e dedikuara të bicikletave dhe këmbësorëve janë një pikë shumë e rëndësishme për këtë vision.

Është e rëndësishme të implementohen disa rregulla dhe një mentalitet i ri për qarkullimin rrugor.

Të përmirësohet qarkullimi duke përfshirë dhe linjën e bicikletave.

Lëvizja këmbësore është gjithashtu një pikë e rëndësishme, pasi qyteti i Tiranës është një sipërfaqe lehtësisht e përshkueshme. Kjo arrihet duke zgjeruar trotualet e duke rritur komoditetin këmbësor. Gjithashtu të krijohen më tepër mundësi për këmbësorët që do të kalojnë rrugët kryesore me trafik të rënduar.

- Zgjerim i rrjetit këmbësor
- Rritje të cilësisë së rrugëve këmbësore duke shtuar dhe hapësirat publike
- Të parashikohen të drejtat e këmbësorëve në legjislacion

Përsa i përket transportit public në një qytet policentrik:

- Të vendoset dhe të zgjerohet linja e dedikuar e transportit public
- Të përmirësohet rrjeti i autobusëve për të lidhur nyjet me densitet të lartë

Në një qytet policentrik:

- Nëse shmanget trafiku nga kjo qendër ekzistuese atëherë udhëtimet dhe lëvizjet e makinave do të zhvillohen jashtë kësaj qendre. Aktualisht kemi vetëm një qendër për qytetin i cili tashme ka një kapacitet shumë të madh.
- Duke krijuar qendra të reja këto do të jenë pole tërheqëse të cilat do të ulin kërkesën që të gjithë të jenë vetëm në këtë qendër që kemi.
- Nëse ndërtojmë rrugë do të kemi makina dhe trafik, nëse ndërtojmë rrugë për këmbësorët atëherë do të kemi një qytet me qasje drejt këmbësorëve dhe bicikletave.
- Në vend që të zmadhojmë rrugët duhet të zvogëlojmë trafikun.
- Të demotivojmë njerëzit që të marrin makinat

Disa mjete të propozuara për të arritur një ekuilibër në lëvizshmërinë e qytetit:

- E vetmja mënyrë për të ndryshuar gjendjen e mobilitetit është që të heqim makinat sa më shumë.
- Është shumë i rëndësishëm një mentalitet i ri për qytetin. makinat të përdoren vetëm për udhëtime të gjata.
- Tirana ka mundësinë për të kaluar në një tjetër fazë pa përsëritur gabimet e qyteteve të tjera europiane.
- Duhet theksuar edhe që mënyra më e mirë për lëvizjen është me tren apo metro. Duhet të bëhet hekurudha pasi ka eficienc më të lartë në shpejtësi, ekonomi, mjedis etj.
- Lëvizjet më të mëdha në qytet janë brenda për brenda dhe nqs do të vështirësojmë lëvizjen me makinë duke vështirësuar dhe parkimin, atëherë nuk do të përdoren më makinat.

Nga pikëpamja e mobilitetit do të optimizohet unaza e tretë dhe do të përfundohet unaza e pestë të cilat do të përballojnë transportin privat të makinave. Aksesit kryesor do të bëhet nëpërmjet rrugeve radiale dhe më pas do të detajohen akseset e brendshme të këtyre zonave ndërmjet.

Zona pedonale e qytetit të Tiranës do të jetë Brenda unazës së vogël, por edhe brenda unazës ekzistuese do të kemi një zonë me trafik të limituar duke e menduar kështu që qyteti të jetë më tepër i këmbësorëve.

Pra kemi një koncept të ri ku zona Brenda unazës së vogël është këmbësore dhe më pas kemi zonën me trafik të limituar (nga unaza e vogël deri në unazën ekzistuese).

Park and ride në Tiranë do të funksionojë shumë mirë

- Do të funksionojë park and ride në unazën ekzistuese ku njerëzit do të hyjnë në qytet ose me bicikletë ose këmbësore.
- Megjithatë për këto zona me trafik të limituar do të jenë rrugët e hapura për rezidentët si edhe për pjesën që do të paguaj taksën e vendosur për hyrje në këtë zonë.

- Në vend që të zmadhojmë rrugët do të zvogëlojmë trafikun.
- Kemi një plan strategjik dhe jo një plan të detajuar dhe cdo gjë do të zgjidhet në momentin e duhur.
- Do të jepen zgjidhje specifike por për momentin është e rëndësishme të biem dakort me këtë mentalitet të ri të organizimit të lëvizjes.
- Tirana është një qytet me densitet të lart por gjithashtu edhe një qytet lehtësisht i përshkueshëm me këmbë.

Kryesorja dhe shumë e rëndësishme për qytetin është të përfundojmë netëorkun ekzistues.

Duhet patjetër ta nisim duke dekurajuar përdorimin e makinave dhe këtë e bëjme duke vendosur edhe taksa për ata që duan të përdorin makinën në qendër të qytetit. Duke qënë se nuk ka mjaftueshëm hapësirë për të gjithë këtë kapacitet makinash në Tiranë, duhet patjetër të ulët numri i makinave të përdorura. Duke përmirësuar rrjetin rrugor do të arrijmë të ndërgjegjësohen njerëzit që përdorimi i bicikletës, ecjes apo transportit public është një zgjidhje më e mirë për lëvizjet Brenda qytetit. Problem kryesorë është sit e ndryshojmë sjelljen e përdoruesve të rrugës.

Mënyra se si do të bëhet shpërndarja e shërbimeve në këtë system te ri të propozuar:

- Do të shpërndahen shërbimet. Unaza e pastë do të jetë ajo më e aksesueshmja dhe do të fillohet nga kjo duke iu drejtuar qendrës.
- Do të ndryshojë sjellja: Tani është që të gjithë vijnë në sheshin Skënderbej që më pas të arrijnë destinacionet e tjera. Do të jetë e kundërta, unazat do të jenë pikë tërheqje nga ku me pas do të bëhet shpërndarja.
- Nuk do të fokusohemi në ndërtimin e rrugëve të reja por në optimizimin e ekzistueseve dhe përshkueshmëria e atyre rrugëve që nuk e kanë këtë.
- Rrjeti rrugor do të plotësohet
- Duhet të kemi një transport dinjitoz ku përfshihen trena, autobuze etj
- Do të kemi korsi të dedikuara për transportin public dhe bicikleta
- Në këtë vision këmbësori ka prioritetin.



BASHKIA
TIRANË

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

TAKIMI

DISKUTIME TE HAPURA

QELIMI:

KËSHILLA DHE VIZIONE NGA EKSPERTË

Procës-verbal i datës:

21/06/2016

Vendndodhja:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Hotel The Plaza Tirana

PJESMARRËS NGA BASHKIA E TIRANËS:

Tavolina: Agroturizmi

Shpëtim Sina	Administrator ShënGjergj	sinashpëtim67@gmail.com 0682217925
Artur Galanxhi	Drejtor, APR Bashkia Tiranë	agalaxhi@yahoo.com 0692063249
Enver Hysa	Përgjegës I Shërbimeve, ShënGjergj,	0682033869
Hana Nanciez	UNLAB	h.nanciez@stefanoboeriarchitectt.com
Astrit Lala	APR Bashkia Tiranë	astrit.lala68@yahoo.com 0692669289
Enkelejda Beja	Bashkia Tiranë	MOT Prot bejaenkelejda@yahoo.com

Historiku:

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT
Sektoret e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit

- Tirana ka qenë prodhuese e rëndësishme për disa produkte specifike bujqësore – blegtorale.

Ka pasur një sasi dhe llojshmëri të madhe produktesh që eksportoheshin jashtë vendit nga rrethinat e Tiranës.

Katër shtyllat kryesore të prodhimit janë:

- Perime
- Fruta
- Ullinj
- Blegtori.

Rajonizimi dhe specializimi.

Korridoret bujqësore të trashëguara janë:

- Bërzhitë –Vaqarr
- Kashar
- Zall-Herr
- Shëngjergj
- Mendimi ynë është që korridoret bujqësore të shtohen.

Të specializohen zona të ndryshme, për prodhime të caktuara, të ngrejme prodhimin ,të krijojmë rrugë të reja marketingu.

Gjithashtu duhet të rrisim vlerën e produktit:

Kjo realizohet me anë të standartizimit dhe ambalazhimit.

Të krijojmë brand – e (marka) autoktone.

Ne kemi shumë prodhime të njohura si p.sh.patatja e Shëngjergjit, etj...

Kjo është një mundësi e mirë që iu jepet fermerëve për të shitur prodhimet e tyre. Ata nuk përdorin teknologji, kimikate, pra, kemi një prodhim bio.

Një mendim tjetër sugjeruar në tavolinën tonë është :

Kombinimi i Parqeve Rekreative –zhvillim bujqësor - agroturizëm.

E rëndësishme është të krijojmë mundësinë e tregtimit të produkteve vendase – green market në lagje por edhe supermarkete.

-Ujitja

Është shumë e dpmosdoshme të funksionojë ujitja e cila realizohet kryesisht nëpërmjet lumit Erzen dhe 60 rezervuarëve që disponohen.

Gjithashtu duhet ti mbështesim në zhvillimin e agroturizmit, dhe turizmit malor në të gjitha stinët.

Për këtë shërbejnë shumë promovimet e herëpasshershme, përvojë kjo e prekur tashmë nga Bashkia e Tiranës.



BASHKIA
TIRANË

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

TAKIMI

DISKUTIME TE HAPURA

QËLLIMI:

KËSHILLA DHE VIZIONE NGA EKSPERTË

Procës-verbal i datës:

021/06/2016

Vendndodhja:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Hotel The Plaza Tirana

PJESMARRËS NGA BASHKIA E TIRANËS:

Tavolina: Menaxhimi i asetëve
mjedlore dhe hapsirave publike

Frida Pashako	Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; Bashkia Tiranë	f.pashako@gmail.com
Blendi Gonxhja	Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit	bgonxhja@gmail.com
Diana Mile	Drejtorja e Politikave dhe Edukimit Mjedisor	mile.diana2@gmail.com
Eliona Çelaj	Sektori i Mikroplanifikimit	eliona.çelaj@tirana.al
Paulo Topuzi	Sektori i Makroplanifikimit	Paulo.Topuzi@tirana.al
Etleva Bodinaku	Eksperte Mjedisi	ebodinaku@yahoo.com
Frederico Panela	Partnerë të UNLAB	www.unlab.eu
Franceska Benedeto	Partnerë të UNLAB	www.unlab.eu

Hyrje

Ajo që është më e rëndësishme për hartimin e Planit të Ri Vendor të qytetit të Tiranës është pjesëmarrja e të gjitha grupeve të interesit, dhe për më tepër marrja e konsultave dhe e ideve të

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Sektorët e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit

specialisteve, atyre njerëzve që e jetojnë vërtet këtë qytet dhe që përballen çdo ditë me problematikat e qytetit.

Gjetja e zgjidhjeve është shumë e rëndësishme, mund të ndërtojmë një strategji të mirfilltë për të evidentuar propozimet më të mira që mund të çojnë në zgjidhjen e problemeve por njëkohësisht mund të ruajnë ekuilibrin mes sistemit urban dhe atij natyror. Tirana ka vlera natyrore të jashtëzakonshme të cilat duhet të ruhen dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme.

Tre korridoret lumore si pjesë e rëndësishme të planit të ri vendor për qytetin e Tiranës

Konceptimi i Planit të ri Vendor përfshin tre korridore të rëndësishme lumore siç janë :

1. Korridori Lumit Erzen;
2. Korridori Lumi të Lanës ;
3. dhe Korridori i lumit të Tiranës.

Për këto tre korridore lumore përcaktohen tre strategji të ndryshme referuar karakterit dhe vendndodhjes së tyre.

1. Lumi i Erzenit jep karakterin një parku linear përgjatë tij, duke dhënë idene e një parku periurban, mëqënëse është një korridor që lidh Tiranën me Durrësin. Kjo zonë mund të shërbejë si një atraksion turistik i cili mund të sjellë karakterin rural brenda hapsirës urbane të një qyteti siç është Tirana ; Rivitalizimi i lumit të Erzenit mund t'i shtojë vlerat zonës rurale, e cila e kombinuar me arkitekturën dhe agro-kulturën mund të përbëjë një aset të rëndësishëm të qytetit tonë.
2. Lumi i Lanës paraqet një problematike tjetër që ndryshon nga lumi i Erzenit. Lumi i Lanës ka si prioritare përmirësimin e kushteve higjienike pasi në këtë rrjedhë lumore derdhen një pjesë e konsiderueshme e kanalizimeve (ujëra të bardha + ujëra të zeza) të qytetit të Tiranës, ç'ka përbën dhe problemin kryesor. Lumi i Lanës përveç të tjerave, përbën dhe një element i rëndësishëm urban pasi e ndan qytetin e Tiranës në dy pjesë.

Popullsia e Tiranës po rritet dita ditës prandaj duhen gjetur alternativa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit. Një mundësi e zgjidhjes së këtij problemi është edhe implementimi i impianteve të pastrimit të ujrave përgjatë lumit, impiante këto të cilat bëjnë një ndërhyrje të pjesshme pa qënë e nevojshme të ristrukturohet i gjithë sistemi i kanalizimeve i cili mund të jetë shumë i vështirë dhe me një kosto shumë të lartë. Impiantet e pastrimit të ujit mund të trajtohen si elemente të mobilimit urban me karakter arkitektonik që mund t'i bashkangjitet sipërfaqeve të gjelbra përgjatë Lanës. Impiantet e pastrimit të ujit mund të na japin një zgjidhje të kushteve higjienike dhe njëkohësisht mund të zgjidhë problemin e përmytjeve në shtratin e Lanës nga shirat sezonal. Propozime të tjera lidhen me detajimin e dizajnit urban përgjatë lumit si psh trajtimi i urave të këmbësoreve me funksione të cilat mund të jenë atraktive dhe mund t'ia shtojnë vlerat hapsirave publike të krijuara përgjatë Lanës.

3. Lumi i Tiranës gjithashtu trajtohet si një potencial i ardhshëm si një korridor i gjelbër i cili mund të kombinojë aktivitete të ndryshme të cilat mund ta bëjnë akoma dhe më tepër atraktive këtë zonë në të ardhmen.

Pylli orbital (Unaza e katërt) dhe brezi i gjelbër (vija e verdhë e re)

Strategji tjetër në diskutim është "pylli orbital" (unaza e katërt si brez i gjelbër) dhe brezi i gjelbër (vija e verdhë), cili është ndryshimi midis tyre;

1. Pylli orbital është një brez i gjelbër i cili shtrihet në unazën e katërt, ky brez i gjelbër do të integrohet me transportin publik dhe infrastrukturen e gjelbër. Ky brez do të shërbejë për të rritur biodiversitetin brenda qytetit si dhe një unazë për të lidhur më mirë njerëzit me njëri tjetrin nëpërmjet transportit publik; Njëkohësisht ky brez do shërbejë për kufizimin e rritjes së zhvillimit duke i qëndruar besnik parimeve të një qytetit kompakt.
2. Brezi tjetër i gjelbër përbëhet nga hapsira të gjelbra në periferi rreth e rrotull Tiranës në të cilat nuk mund të ndërtohet pasi këto sipërfaqe do i dedikohen ruajtjes së pyjeve dhe hapsirave agrikuturore në mënyrë që zgjerimin urban i qytetit të parandalohet ose të ketë një rritje të qëndrueshme.

Qyteti i Tiranës parashikohet të ketë një zhvillim hapsinor policentrik, ku i jepet potenciali i duhur zhvillimor disa qendrave të cilat e kanalizojnë zhvillimin e ardhshëm në një rrjedhë me të qëndrueshme; Këto potenciale zhvillimi me fjale të tjera quhen pole zhvillimi.

Problematika të tjera

Mobiliteti i Tiranës është një pikë tjetër me një rëndësi jetike. Zgjidhja e një skeme funksionale dhe përdorimi i metodave inovative mund të kenë një ndikim të madh në cilësinë e jetës në qytet si dhe të reduktojnë emetimin e gazrave që çojnë në efektin serë.

Problematike tjetër lidhet me Ish-zonat industriale, të ndërtuara para viteve 90, tashmë ndodhen në gjëndje tejet të amortizuar! Ndërhyrja në këto zona duhet të jetë e menjëhershme, jo vetëm në aspektin e rigjenerimit urban por edhe në aspektin purifikues të tokës ku ka patur industri të mëdërpëshme të cilat kanë lënë ndotje edhe sot e kësaj dite.

Tiranë, Qershor 2016



BASHKIA
TIRANË

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

TAKIMI: **DISKUTIME TE HAPURA**

QËLLIMI: **KËSHILLA DHE VIZIONE NGA EKSPERTË**

Procès-verbal i datës: **21/06/2016**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Vendndodhja: **Hotel The Plaza Tirana**

PJESMARRËS NGA BASHKIA E TIRANËS:

Tavolina: **ZONIMI I QYTETIT
DHE RREGULLORET N.1**

Gjon Radovani	Zv/Minister, Ministria e Zhvillimit Urban	gjon.radovani@zhvillimi.urban.gov.al		
Florian Nepravishta	Dekan, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	f_nepravishta@yahoo.com		
Armand Vokshi	Departamenti i Urbanistikës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës Kryetar, Shoqata e Arkitekteve dhe Urbanistëve	armandvokshi@gmail.com		
Ditjon Baboçi	DPPZHT, Bashkia Tiranë	ditjon.baboci@tirana.al		
Ulrike Bega	Studio Symbiotika			
Dorina Pllumbi	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	dorinapllumbi@yahoo.com		
Nada Ibrahimimi	Bashkia Tiranë	nada.ibrahimi@tirana.al		

- TDR (Transfer of Development Rights) ose transferimi i të drejtës së zhvillimit ishte një nga çështjet e diskutuara në tryezë.

Gjetja e një formule apo logjike të saktë e cila llogarit dhe vendos mënyrat e

trajtimit dhe menaxhimit të pronës mbetet një sfidë e planifikimit dhe zhvillimit në

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
Sektoret e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit

vite. E rëndësishme mbi të gjitha është që formula e menaxhimit të jetë pjesë e një sistemi të drejtë, përndryshe nuk do funksionojë. Ndoshta plani dhe rregullorja e re duhet të parashikojnë edhe një sistem përjashtimesh brënda tyre, duke qënë se situatat shpesh janë relative, mjafton mbështetja e çdo vendimi në një standart të shkruar dhe të aprovuar ligjërisht.

- Duhet kuptuar që vendimi mbi të gjitha duhet përshatur me kontekstin, prandaj edhe vende të ndryshme punojnë në mënyra të ndryshme të cilat kryesisht janë bazuar në praktika ligjore të përgjithshme dhe të veçanta. Ajo çka është e rëndësishme të aplikohet është e drejta e barabartë e të gjithëve përballë shtetit edhe ligjit.
- Element tjetër i diskutuar në tryezë ishte edhe trajtimi i Tiranës, duke u nisur edhe nga kufiri i ri administrativ. Trajtimi i qendrës, e cila deri diku konsiston në kufirin e vjetër administrativ si dhe logjika e trajtimit të periferive të cilat ndoshta duhen parë në tre këndvështrime të ndryshme të cilat do të lidhen me ndarjen e tyre sipas kontekstit fizik. Lidhur me sa më sipër, periferitë duhet të ndahen në periferinë 1 (periferia e Tiranës së vjetër administrative), periferia 2 (kufiri nga unaza e 5 deri në komuna) dhe periferia 3 (ish komunat të cilat janë pjesë e kufirit të ri administrativ). Për secilin nga rastet sistemi menaxherial i pronës dhe hapsirës duhet të jetë i ndryshëm.
- Sistemi menaxherial i pronës duhet të shihet dhe konceptohet si një logjikë e cila lidhet me të gjitha elementet dhe nivelet e planifikimit territorial. Zoom In dhe Zoom out janë nevoja të cilat do të duhet të gjenerojnë menyrën e konceptimit të të drejtës së zhvillimit. Prandaj fillimisht qyteti duhet studiuar në shkallë të gjërë e më pas të trajtohet në shkallë më të vogël. Të dyja këto janë koncepte aq sa të ndryshme nga njëri tjetri, aq edhe të ngjashëm përsa i përket gjenerimit dhe llogjikës së zhvillimit të hapsirës.
- Qëndrat policentrike janë koncepte të cilat kanë kohë që trajtohen në teoritë e zhvillimit të qytetit, por që asnjëherë nuk janë bërë pjesë praktike e tij duke u zbatuar si pasojë e mungesës së një plani menaxhimi. Që të jenë sa më thjesht të realizueshme, këto ide duhet që kryesisht të zbatohen në zona të cilat e kanë kapacitetin e kthimit në poliçendra. Nëse do të dilnim në raste konkrete keto do të

ishin ish zonat industrial, ish zonat ushtarake etj. Me të tilla njësi qyteti është i mirëpajisur, ndaj ndoshta do të duhen të merrën në konsideratë.

- Përsa i përket qëndrave duhet analizuar edhe perceptimi i objektit kryesor që do të përcaktojë një të tillë. Objekti mund të ishte një element fizik (shkollë, objekt kulti, objekt tregtar) apo edhe element abstrakt (taksat).
- Objekti fizik vjen për tu diskutuar. Cdo vendimmarrje duhet të jetë pasojë e një analize dhe një planzhvillimi të bërë nga bashkia, i cili duhet të jetë shumëdimensional. Në këtë mënyrë edhe objekti i cili do të definojë qëndrën do të vijë si pasojë e një analize të thellë .
- Konkretisht shkolla, ky element të cilin plani i Boerit e trajton si elementin i cili përcakton qëndrën duket se ka problematikën e tij. Patjetër që kryesisht poliçendra ka një karakter, por duhet patur parasysh se në qytetet karakteristike Shqiptare shkolla shfaqet si një objekt problematik. Kjo për dy arsye kryesore; fillimisht shkolla ka nevojë për një kufi të rreptë sigurie si dhe niveli jo mirë pedagogjik që ne ofrojmë, për fat të keq nuk favorizon. Për të përcaktuar një poliçendër objekti duhet të shfrytëzohet pikat më të forta të një shteti, qoftë në të ardhura, resurse apo edhe mentalitet. Shkolla, pavarësisht se konsiston në një katalizator të fuqishëm nuk është zgjidhja më e mirë sa i përket arsyetimit të mësipërm.
- Ndërkohë që sistemi i taksave mund të jete një zgjidhje e zgjuar. Në këtë mënyrë qyteti zhvillohet me lote të cilat në një farë mënyre janë të indikuara nga institucionet, dhe si pasojë të mirëstudiuara. Ulja e taksës për zonat ku bashkia do vendosi se ka interes zhvillimi përsa i përket qëndrave do të inkurajonte zhvilluesit për tu orientuar drejt tyre.



TAKIMI:

DISKUTIME TE HAPURA

QËLLIMI:

DISKUTIM FAZA E TRETË E PLANIT

Proces-verbal i datës:

26/12/2016

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Vendndodhja:

The Plaza Hotel

PJESMARRËS NGA BASHKIA E TIRANËS:

Ditjon Baboci

Drejtor i DPPKZHT

Ditjon.Baboci@tirana.al

Arbi Mazniku

Nenkryetar i Bashkisë

Arbi.Mazniku@tirana.al

Nevin Bilali

Keshilltare e Kryetarit

Nevin.Bilali@tirana.gov.al

Devis Agaraaj

Sektori i Makroplanifikimit

Devis.Agaraaj@tirana.gov.al

Mirinda Shqami

Sektori i Makroplanifikimit

Mirinda.Shqami@tirana.gov.al

Soviela Shehu

Sektori i Makroplanifikimit

Soviela.Shehu@tirana.al



Z. Baboci mbajti fjalën e hapjes duke falenderuar të gjithë për punën dhe për pjesmarrjen.

Z. Dalipi bëri një prezantim të shkurtër për çfarë do të bëhej dëgjesa.

Z. Veliaj mbajti fjalën duke përshëndetur dhe duke thënë përse e kishim kaq të nevojshëm një plan kaq të madh.

Pas prezantimit të planit nga Boeri, Francesca, Andreas fjalën e morën anëtar të Këshillit Bashkiak për të bërë komentet dhe për të shtruar pyetjet e tyre.

Ilda:

1. Sipas statistikave numri i popullsisë në Tiranë po vjen në ulje si e keni parashikuar këtë fakt?
2. A do të kemi pallate më të larta në Tiranë dhe a është kjo një politikë zhvillimi e mirë?
3. A do të zhvillohen me të njëjtën gjuhë edhe periferitë?

Besnik Aliaj:

1. Nga aspekti ligjor, procesi që po zhvillohet sot ka një problem të madh. Planifikimi duhet të jetë instrument që i lidh palët, duhet të ishim në dijeni për çdo gjë gjatë gjithë procesit. Që një muaj para duhet të ishte depozituar i gjithë dokumentacioni që të kishim më tepër kohë në dispozicion për ta shqyrtuar. Kemi hyrë në një proces informaliteti. Duhet të kthehemi dhe të shqyrtojmë shtruar. Nëse injorohet kjo pikë plani është informal.
2. Për mendimin tim është një plan jashtë kontekstit dhe realitetit shqiptar. Për shembull, përmbytjet dhe trafiku janë katastrofike në Tiranë.
3. Në tërë këto vite është përdorur ekspertiza e huaj si alibi për anti planifikim. Ne jemi në një kohë që kemi boll ekspertë shqipëtar të cilët do të ishin një ndihmë për planin.
4. Pylli periferik është shumë i inspirues por kam dyshime dhe rezerva se sa do të realizohet ky projekt.
5. Të thuhet dhe ti dimë të gjitha komentet e AKPT-së.
6. Mbi deklaratat mjedisore kam dyshimet e mia. Nga ministria e mjedisit vjen frika që ky vizion nuk do të mund të implementohet pa patur një impakt të madh në mjedis.
7. Nuk është parë qyteti si një organizëm i gjallë; si vepron qyteti në territory në realitet?
8. Në gjithë atë vizion nuk kemi ndërveprim me Kamzën, Vorën pasi nga ana ekonomike dhe sociale këto janë pjesë e Tiranës. Nuk mund të krijohen dy realitete.
9. P'adashur keni promovuar "Sprawl". Cili është ai rrjet rrugor që do të bëjë identitetin e ri të Tiranës? Nuk është krijuar një identitet për zonat periferike.
10. Nuk ishin shumë të qarta konkluzionet që u nxorrën në fund.
11. Nuk pashë plan serioz investimesh në infrastrukturë. Sa kushtojnë këto investime?
12. Ekonomia është e rëndësishme, po ku qëndron njeriu në këtë mes? Ca do ndodhë me biznesin e vogël familjar?
13. Nuk duhet të jetë zgjidhje politike. Cili është plani për përmbytjet në Tiranë. Infrastruktura mu duk pikë e dobët e planit. Tiranës së madhe i duhen 170 km rrugë të reja dhe nuk pashë një rrjet të ri që do të hapet.
14. Transporti publik dhe sidomos trami është shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm.
15. Kriza e ndotjes së ajrit. Cfarë ndodh me kanalizimet?



16. Kishte ndjeshmëri për parqet, por si do realizohen?
17. Zhvillimi Kaleidoskopik do fragmentizoje qytetin, do thyeje pasqyrën.
18. Cilat janë njësitë territoriale me indikator më të lartë të zhvillimit Ku janë parcelat që do rriten? Kush është përfituesi? Sa % e kësajpronësie shkon tek pronari dhe sa tek interesi publik?
19. Mendoj që planit i mungon një skelet, një strukturë.

Elisa Spilropall:

1. Qendra pedestrale ka shkaktuar trafik. Si do adresohet ky problem?

Klodi:

1. Poliçendrat – do doja pak më tepër informacion për tipologjitë dhe konceptin e tyre.
2. Më pëlqën ideja e "open public spaces", po për shkollat do jenë të përfshira dhe ato ekzistuese, si dhe private?

Flori:

1. Ka një studim të saktë banorësh? Shkollat që do të ndërtohen a janë shpërndarë në mënyrën e duhur për të përballuar fluksin edhe në zonat periferike?

Aklli:

1. Në sa takime keni marrë pjesë ju italianët, dhe a mund të më thoni tre problematika që ju kanë thënë njerëzit?
2. Sharra, mbetjet, riciklimi. Ku do shkonë mbetjet?

Nardi:

1. A ka një zgjidhje brenda këtij plani për sa i përket ujit të pijshëm? Kur do realizohet dhe kostoja?

Arjan:

1. Metrobosko është një ide shumë e mirë. A është parashikuar për sa kohë realizohet dhe në çfarë pengesash has?
2. Zhvillimi i lumit të Tiranës, çfarë pozicioni do të zërë ky lum kundrejt lumit të Lanës?
3. Tirana policentrike – si do të zhvillohen këto qendra? Si do të funksionojnë shpronësimet?
4. Rritja e intensitetit dhe ulja e KSHT concept interesant dhe modern.
5. Çfarë ekzaktësisht dhe si do të japin bonuset?
6. Si do të funksionojë transferimi i të drejtës së pronarëve të truallit?
7. Çfarë praktike do të ndiqet për të realizuar riformatimin e volumeve ekzistuese?
8. Tirana ka qenë qytet radial. A do ngelet ky concept akoma?
9. A janë marrë parasysh studimet e JICA?



Albina:

1. Transporti publik, duke qenë se populli po rritet, cila është strategjia për zgjidhjen?
2. Zhvillimi rural. Fermat e sotme është një fermë familjare dhe shumë e vogël. Si është menduar zhvillimi dhe konsolidimi i këtyre fermave?
3. Si është menduar konsolidimi i tokës bujqësore? Ta ruajmë dhe ta rrisim shfrytëzimin e kësaj toke bujqësore?
4. Po impiantet e biogazit a mund të realizohen në Shqipëri?

Arditi:

1. A është parashikuar në mënyrë të detajuar zhvillimi në qendrat e reja të qytetit? A i përgjigjet zhvillimit demografik, ekonomik e kulturor?

Më pas vijuan pyetjt nga publiku:

1. A ka një figurë qendrore nga arkitekt Shqipëtar që qëndron pas planit?
2. A parashikon ky plan një projekt reabilitimi të disa zonave problematike në Tiranë?
3. Mos po implementoni planin ende pa u miratuar masterplani?
4. A ka një plan B në rast se ky nuk funksionon?
5. Parkimet nuk i pam të detajuara
6. Sa do të ndërtohet me saktësi dhe çfarë intensiteti?
7. Arsimi: a ka shkolla edhe në kombinat? Pasi dendësia ishte përqëndruar në qendër.
8. Çfarë do të bëhet për zhvillimin industrial?
9. Sa është kosto e këtij plani dhe çfarë ndikimi do të kenë këto në taksat e qytetarëve?
10. A ka projekt për rrugë nga pjesa lindore e liqenit?